



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 114

Prishtinë, më 20.6.2024, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Rrustemi, Driton Selmanaj, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Hajdar Beqa, Erxhan Galushi, Hydajet Hyseni- Kaloshi dhe Besnik Tahiri.

Mungoi: Blerta Deliu-Kodra.

Mbledhjen e kryesoi Adnan Rrustemi, kryetar i Komisionit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Fjolle Haziri, KDI; Diellza Gashi, Ekonomia Online; Zgjim Sefa, Ideksonline; Bujar Dakaj, asistent; Viona Bunjaku, Levizja FOL; Benjamin Lerants, Levizja FOL; Valon Dobruna, Kuvendi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 08/L-272 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149;
3. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve kryesore për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
4. Shqyrtimi i Raportit për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat Pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;
5. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime me 6 vota për.

2. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 08/L-272 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149;

Kryetari, tha se Komisioni për Buxhet, punë dhe transfere, në mbledhjen e mbajtur më 5.6.2024, shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-272 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 me amendamentet e propozuara dhe vendosi që Komisionit funksional t'ia paraqes këtë rekomandim që projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për Noterinë me amendamentet e propozuara nuk përmban kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në mbledhjen e mbajtur më 7.6.2024, ka konstatuar që amendamentet e propozuara nuk çenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Komisioni për Integrim Evropian nuk e ka trajtuar raportin me amendamente brenda afatit të përcaktuar me rregullore dhe rrjedhimisht në ecim tutje dhe përmbushet periudha prej dy javësh për veprim të komisioneve të përhershme në bazë të nenit 76 të paragrafit 8 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili përcakton se Komisioni i përhershëm shqyrton projektligjin me amendamente e propozuara nga komisioni përgjegjës raportues si dhe amendamentet e propozuara nga të autorizuarit sipas paragrafit 3 të këtij neni, brenda 15 ditësh, andaj në mund të procedojmë më tutje për ta dërguar në seancë.

Dimal Basha, tha se ka një vërejtje të vogël tek amendamenti 8, në e kemi pasur “sistemin informativ për menaxhimin për zgjedhjen e noterit” që ka qenë shumë e komplikuar ku pastaj e kemi ndryshuar si “sistemi informativ për profesionet e lira”, pra prej SIMPZN në SIPL dhe tek amendamenti 8, do të duhet si në vijim neni 7 në paragraf thotë 1, 2 dhe 3 akronimet SIMPZN zëvendësohen me akronimet SIPL dhe paragrafi 1 fjalët “sistemi informativ për menaxhimin për zgjedhjen e noterit”, zëvendësohen me fjalët “sistemi informativ për profesionet e lira”.

Driton Semanaj, pyeti se përse nuk është i përfshirë edhe raporti i Komisionit për Integritet Evropian sepse nuk është që kemi qenë kaq strikt në afate sepse kemi ligje që janë në procedurë tash e një vit dhe i kemi shkelur afatet procedurale të rregullores së punës së Kuvendit dhe tani pse nuk kemi pritur edhe raportin e një komisioni tjetër të përhershëm siç është Komisioni për integritet, sepse Komisioni për integritet flet për përputhshmërinë apo harmonizimin me legjislacionin e BE-së dhe se për ligjin për KPK-në, kemi pasur disa raporte të Komisionit të Venecias dhe është e domosdoshme ta kemi edhe raportin e Komisionit për Integritet Evropian, në mënyrë që ne më pas t'i miratojmë si të tilla.

Kryetari, tha se nuk ka asnjë arsye të veçantë se përse nuk është pritur edhe raporti i KIE, por për çdo projektligj në mes të dy leximeve kur bëhet fjalë për shqyrtimin e raporteve me amendamente nga komisionet e përhershme, secili komision i përhershëm përfshirë edhe Komisionin për legjislacion, kur është në funksion si komision i përhershëm i kemi 15 ditë për të miratuar ose jo

një raport me amendamente. Në momentin kur afati tejkalohet komisioni funksional është i autorizuar që të zhvillojë procedurën dhe Komisioni për legjislacion ka miratuar raportin me amendamente më 23.5.2024 dhe sot jemi me datën 20.6.2024 dhe nuk janë 15 ditë në pyetje, por një muaj dhe përse nuk është mbledhur Komisioni për Integritet Evropian është çështje krejtësisht e tyre. Komisioni për legjislacion ka planin e vet të veprimit dhe ne vendosim se kur i rendisim këto pika të rendit të ditës. Nuk ka projektligje me amendamente që i ka kaluar Komisioni funksional që janë në procedurë me muaj të tërë.

Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se Komisioni, me 6 vota për dhe 1 abstenim me ndryshimet e cekura si më sipër, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë për miratim këtë:

R A P O R T

Për Projektligjin nr. 08/L-272 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149;

3. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;

Kryetari, tha se Komisioni për Legjislacion ka miratuar raportin me amendamente dhe është dërguar në tre komisionet tjera të përhershme, Komisioni për Buxhet punë dhe Transfere, Komisioni për të drejtat e Komuniteteve dhe Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian që të japin vlerësimin e tyre. Komisioni për Buxhet punë dhe transfere dhe Komisioni për të drejtat e komuniteteve dhe kthim e ka shqyrtuar dhe ka rekomanduar miratimin, ndërkohë që KIE nuk ju ka përmbajtur afatit të përcaktuar, kështu që ne ecim tutje.

Driton Selmanaj, tha se këtë projektligj e kemi trajtuar më 24.5.2024 dhe unë e kam votuar kundër dhe është thënë se nuk po respektohen apo po lexohen ndryshe rekomandimet e Komisionit të Venecias, mirëpo, ajo që e shoh si shqetësuese është se nuk jemi informuar që kryetari ka pranuar një letër nga Zyra e BE-së në Kosovë, më 15.5.2024, ku ata ngrenë shqetësimet që nuk janë adresuar gjetjet e raportit të Komisionit të Venecias, ku rekomandojnë fuqishëm që ta rikonsultoni edhe një herë raportin e Komisionit të Venecias dhe se ky dokument është dashur të shpërndahet në komision. E njëjta letër i është drejtuar më 6.6.2024 edhe Komisionit për Integritet Evropian, me rekomandimin që të mos e kalojnë sepse nuk janë marrë parasysh rekomandimet nga raporti i Komisionit të Venecias. Nuk është mirë që po miratoni projektligje nën petkun e reformës, por duke e deformuar sistemin dhe është e pa pranueshme që letrat që na vijnë nga faktorët ndërkombëtarë në Kosovë, e që më pas kjo reflekton në raportin e progresit që ata nxjerrin për Kosovën, që ju mos ta ndani me anëtarët e Komisionit por ta mbani për vete. Është më mirë të ndalet procesi edhe pse ka kaluar në komision dhe të kthehet në Qeveri dhe të vijnë propozime të reja dhe shtoi se këtë projektligj do ta votojë kundër dhe kjo çështje do të përfundojë në Gjykatën Kushtetuese sepse jemi të vendosur të mbrojmë kushtetutshmërinë në këtë vend.

Kryetari, tha se Komisioni për Legjislacion ka formuar grupin e punës për ta trajtuar projektligjin dhe përveç qe kenë pasur mundësinë madje jeni ftuar e jeni lutur që të përfshihen në grupin e punës. Në mbledhjet dhe punëtoritë e organizuara nga grupi i punës i kryesuar nga unë, kanë marrë pjesë akterë të ndryshëm institucional e ndërkombëtarë, përfshirë edhe Zyra e Bashkimit Evropian dhe është trajtuar secili rekomandim i Komisionit të Venecias në raport me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në pikëpamje profesionale jo politike për t'i dhënë adresimin adekuat dhe në fund të fundit, Komisioni i Venecias ka dhënë rekomandime dhe nuk ka dhënë dispozita. Rekomandimet duhet të shndërrohen në dispozita materiale në projektligj, por procesi i shndërrimit është një punë profesionale që sintetizon qëndrimet që jepen nga pjesëmarrësit në punëtori.

Sa i përket çështjes së letrës së dërguar nga zyra e BE-së, ka qenë në fazën e shqyrtimit të projektligjit në grupin e punës dhe e kam trajtuar si letër drejtuar kryesuesit të grupit të punës dhe ka pasur qasje secili që është përfshirë në këtë proces. Komentet e zyrës së BE-se kanë qenë me track changes për dispozita specifike për të cilat jemi takuar dhe besoj se jemi ndal për t'i adresuar në forma të ndryshme apo situata të caktuara. Edhe zyra e BE-së dhe partneret tjerë ndërkombëtarë e kanë parë punën që është bërë drejtpërdrejt në adresimin e rekomandimeve të Venecias, po ashtu, edhe shoqëria civile që e ka mbështetur këtë projektligj me punëtori e me analiza të caktuara dhe e dinë saktë që qëllimi ka qenë plotësisht dashamirës për të trajtuar secilin rekomandim dhe bashkërisht kemi ardhur në këto përfundime. Mund të ketë pikëpamje të caktuara për gjëra jo esenciale se do të mund të ishte formulimi tjetër për një gjë të caktuar edhe pse nuk gjendemi në fazën për ta diskutuar raportin me amendamente. Pra, si përfundim projektligji adreson rekomandimet e Venecias, merr për bazë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese dhe sipas bindjes së tij nuk ka asnjë element antikushtetues. Po ashtu, tha se donte të dëgjonte edhe vërejtjet thelbësore përmbajtësore të deputetit Selmanaj edhe pse nuk është përfshirë në proces duke pohuar se në mbledhjen ku është formuar grupi i punës ke thënë se nuk besoj në idenë e kësaj reforme dhe rrjedhimisht nuk je përfshirë duke e mbajtur veten jashtë dhe nuk ke bërë amendamente në lidhje me këtë projektligj në afatin e përcaktuar, as në grupin e punës nuk ke ardhur për të dhënë propozime, ndërkohë që sot po jep kritikë sipërfaqësore të përgjithshme më shumë për metodologjinë sesa për përmbajtje. Pra puna është bërë me qëllimin më të mirë për të adresuar secilin rekomandim, madje nuk përmbush qëllimet e vlerësimit të tij personal të reformës në KPK sepse është shumë më shumë i moderuar sesa do të duhej të ishte. Reforma në KPK do duhej të ishte më thellë dhe më rrënjësore.

Driton Selmanaj, tha se do të duhej të kishte kujdes nga keqçitimet e fjalëve sepse nuk ke të drejtë për të shtrembëruar fjalët të cilat i kam thënë. Po ashtu, tha se ka folur me argumente profesionale për secilin amendament dhe për secilën çështje për të cilin mendojnë se pse kjo ide është e deformuar sepse nuk është ide për reformim por është ide për kapje të shtetit. Ndërkohë, tha se nuk është duke dhënë vërejtje sipërfaqësore, por është duke pyetur për letrën e Zyrës së BE-së, që thotë se rekomandon fuqishëm ta rikonsultoni edhe një herë Komisionin e Venecias. Pra edhe pas datës 24.5.2024, kur raporti me amendamente është miratuar në komision, me datë 6.6.2024, Zyra e BE-së vazhdon të ketë të njëjtin mendim. Është e ditur që Komisioni i Venecias nuk merr vendime për projektligje, i trajton dhe në fund nxjerr opinione që janë të karakterit rekomandues, por mosmarrja parasysh e rekomandimeve të tyre ka pasoja politike për vendin. Rekomandimi i BE-së thotë se nëse këto rekomandime nuk merren parasysh, ne do të dalim me qëndrimet tona në raportin për Kosovën. Ndërsa ju thoni se intuita ime, dija ime dhe përkufizimi im i akteve normative i mbivalon edhe Komisionin e Venecias, por jeni gabim se nuk po nxirret

ky ligj për një lagje, por për shtetin e Kosovës dhe të jemi të kujdesshëm se çfarë po flasim. Arsyeja pse nuk jam përfshirë në këtë proces ka qenë sepse kam thënë që ideja është e mbrapsht sepse Kosova ka shumë nevojë për reformë në drejtësi, por jo kështu. Edhe pse nuk kam qenë pjesë e grupit të punës jam nënkryetar i këtij komisioni dhe është dashur që këtë letër të ma përcillni sepse e njëjta ka përfunduar në komisione të tjera dhe shumë shpejt do të përfundojë tek të gjithë deputetët.

Kryetari, potencoi se letra i është drejtuar atij dhe shefit të kabinetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe është komplet në fazën e shqyrtimit të projektligjit të grupit të punës. Po të më ishte drejtuar letra në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Legjislacion, natyrisht që do e ndaja me ju përmes administratës, por as letra e zyrës së BE-së nuk ka qenë negative, siç po e paraqet deputeti Selmanaj. Zyra e BE-së ka qenë e përfshirë në çdo fazë, ka dhënë rekomandime që në masë të madhe janë marrë për bazë, ka dhënë përsëri vlerësime në track changes, si formë e kontributit për dispozitat e caktuara janë rishikuar përsëri. Ky është versioni përfundimtar që e kemi sjellë si grup pune e si pjesëmarrës të akterëve ndërkombëtarë e institucional dhe të shoqërisë civile. Ky nuk është vetëm produkti i grupit të punës apo i ministrisë ose i mazhorancës por i të gjithëve që kanë marrë pjesë në këto punëtori dhe duhet të vlerësohet ky angazhimi i përbashkët.

Sa i përket çështjes së numrit të anëtarëve politika e kësaj mazhorance është që numri i anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës të jetë shumë i vogël, të jetë shtatë dhe në projektligjin e parë të cilin e ka rrëzuar Gjykata Kushtetuese, propozimi ka qenë shtatë, por numri nuk ka qenë asnjëherë qëllim ka qenë raporti i anëtarëve prokurorial dhe jo prokurorial dhe përpjekja ka qenë të kemi një përbërje pluraliste që e zhbën dominimin apo karakterin korporativist që e ka aktualisht Këshilli Prokurorial i Kosovës. Pra, raporti anëtar prokuror dhe jo prokuror, ka qenë me rendësi se a do të behej kjo me shtatë anëtarë, me katër, me tre, apo me nëntëmbëdhjetë anëtarë dhjetë me nëntë, apo me pesëmbëdhjetë anëtarë, tetë me shtatë kjo është çështje e formulës por që ky është thelbi është marrja e vendimeve dhe reforma atje. Kjo Qeveri nuk ka qëllim ta kap sistemin sepse nuk na duhet një sistem i kapur sepse nuk na duhet një sistem i kapur. Fakti që përdor argumentin kinse është duke u ç'kapur për tu kapur dhe ndërkohë e kundërshton çdo reformë sepse të mjafton me mbajt gjendjen kështu, kjo i kontribuon deformimit të sistemit të drejtësisë dhe nuk i kontribuon pavarësisë dhe meritokracisë e profesionalizmit. Mund të kemi dallime në modalitete, por asnjëherë status quo në sistem, nuk mund të jete alternativë përballë çfarëdo ndryshimi përveç nëse si strukturë synon me mbajt strukturën aktuale se ke interesa, duke pohuar se nuk mendon që njëri nga ata por me vetëdije apo pa vetëdije je duke kontribuar.

Driton Selmanaj, tha se mos të hy në vlerësime të tilla dhe se ka qenë zëvendëskryeministër dhe ka pasur në portfolio reformën në drejtësi dhe se është angazhuar maksimalisht përfshirë edhe vettingun por jo vetting të dështuar. LDK-ja, është e interesuar që të ketë reformë të mirëfilltë në sistemin e drejtësisë dhe nuk është kjo që ju po e propozoni sepse ju tani e keni sjellë një situatë ku po i dërgoni shtatë anëtarë në KPK, por tre do t'i dërgojë politika dhe gjithmonë me pesë anëtarë do të jetë kuorumi që është rast ndoshta sui generis, pse nuk është kuorumi katër, por pesë. Gjithmonë njeriu i përzgjedhur nga politika do ta bllokojë vendimmarrjen në KPK, nuk do të lejoj të zgjidhet kryeprokurori i vendit dhe do të pengojë kuorumin për avancime dhe rekrutim të stafit dhe shtoi se është i bindur që kjo mënyrë është gabim. Po ashtu, tha se kur e ka parë qasjen se çfarë po ndodh e ka parë se ekziston një qëllim politik përtej kësaj dhe kjo është fatkeqësi. Gjithashtu tha se LDK-në e keni aleate në qëllime fisnike për këtë vend, por nuk mund të bëhemi aleat për

qëllime jo fisnike. Nëse dikush ka investuar që të kapet ky sistem dhe e ka shkatërruar dhe e ka lënduar skajshmërisht, nuk do e lejmë dikë tjetër të bëjë të njëjtën gjë.

Besnik Tahiri, tha se sot e disa herë po e diskutojmë një projektligj që në esencë është ligji më i rëndësishëm i cili do të duhej të forconte sundimin e ligjit, ndjekjen e njerëzve të korrumpuar dhe të njerëzve që kanë precedent penal dhe reformimin e një institucioni i cili përgjatë kohës është diskutuar që e ka nevojën për reformë. Në fillim të këtij mandati kur kemi diskutuar në kryesi për reformën në drejtësi, kam thënë se a kemi qëllimin ta bëjmë këtë reformë njëmend dhe të lëmë disa veprime dhe disa reforma që hyjnë në shërbim të Kosovës në çerekshkullin e dytë, apo do ta bëjmë vetëm sa për të pasur ndikim politik. Për vetingun kam qene gjithmonë skeptik sepse edhe aty kam pyetur a do e bëjmë vetingun me ndryshime kushtetuese apo pa ndryshime. Tek ky projektligj me 24.3.2023, ne kemi marrë një vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe këtu para se të ju referohemi letrave të Bashkimit Evropian, ne duhet t'i referohemi vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Me një lexim analitik dhe kritik të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, brenga kryesore ka qenë trupi që udhëheqë këtë institucion që është Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe kur flasim për këtë trup, tha që pajtohet me kryetarin kur tha se numri nuk ka qenë qëllim por vendimmarrja dhe ndikimi politik në vendimmarrje, përmes anëtarëve joprokurorë. Zvogëlimi i numrit të anëtarëve ka qenë veprim i duhur por problemi me zvogëlimin e numrit është me logjikën e ndikimit politik, përmes një sistemi shumë të sofistikuar të njerëzve që dërgohen aty. Ideja që kryeprokurorit të jetë pjesë e Këshillit Prokurorial të Kosovës, nuk ka qenë asnjëherë e mirë sepse prania e kryeprokurorit bën që trupi të ndikohet gjithmonë. Një trup që ka koncept të udhëheqjes korporatave, siç është përmes bordit niveli duhet të jetë përafërsisht i barabartë. Problemi kryesor është tek përbërja sepse me këtë përbërje të Këshillit Prokurorial të Kosovës, është duke u cenuar pavarësia institucionale, pavarësia që i delegohet me kompetencë dhe mbi të gjitha po i hapen dyert këtij institucioni me pas ndikim të drejtpërdrejtë politik. Para se të shpallim konkursin për Avokatin e popullit edhe për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit duhet t'i shtojmë edhe një kriter, ku thotë që ky person duhet të na dëgjoj për gjithçka sepse kur të zgjidhen këta dy njerëz kanë për të pasur fuqinë e tyre reale për përzgjedhjen e anëtarëve joprokurorë. Qasja është gabim, vendimmarrja është duke u rrezikuar dhe epilogu është që sapo të mbërrij ky ligj ne Gjykatën Kushtetuese, do të bie sepse nuk është trajtuar rekomandimi kryesor i Gjykatës Kushtetuese.

Hajdar Beqa, tha se në fazën në të cilën jemi sot nuk do të lëshohem në materie, megjithatë ne kemi shqyrtuar raportet e komisioneve kryesore, të cilat nuk i kemi të gjitha të kompletuara, siç tha deputeti Selmanaj. Ndërkaq, letrat që vijnë nga institucionet siç është BE-ja në raste të tilla në adresë të kryetarit të komisionit nuk ju drejtohen grupeve të punës sepse grupet e punës janë trupa të komisioneve të cilët nuk marrin vendime, ata vetëm i propozojnë komisionit dhe mund të bëjnë një punë të mrekullueshme, por mundet komisioni të mos ua votojë më tutje. Nga praktika e kaluar shpeshherë ka ndodhur që letra të cilat nuk kanë pasur të bëjnë me fushëveprimtarinë e Komisionit për Legjislacion i kemi sjellë këtu dhe i kemi shqyrtuar dhe kjo letër që ka kuptimin e vet dhe përveç se reflekton në të ardhmen reflekton edhe te vendimi i Gjykatës Kushtetuese. PDK-ja ka dhënë qëndrimin e vet në lidhje me çështjen se kjo mazhorancë i ka pasur numrat që të bëjë reformë në drejtësi, sikur ta kishte vullnetin sepse po të kishte qëllimin njëmend të luftonte korrupsionin nuk do ta kishte lënë Kosovën tash e katër vite pa kryeprokuror dhe ky ligj po bëhet që si ta zgjedhim kryeprokurorin dhe jo si ta bëjmë reformën. Ky ligj si i tillë nuk e kalon filtrin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës sepse ka dhjetëra shkelje dhe ka elemente që e shkel Kushtetutën. Si parti do të jemi gjithmonë kundër, derisa ky ligj të jetë në harmoni me vendimin e

Gjykatës Kushtetuese. Nuk mund të ketë reformë në drejtësi kur numri i anëtarëve prokurorë me ata joprokurorë është gati i barabartë, ndërsa sa i përket çështjes së kryeprokurorit kjo ka qenë në të kaluarën është menduar që është praktikë jo e mirë, pastaj është larguar dhe tani po shihet prapë si praktikë e mirë.

Dimal Basha, tha se këto rekomandime të Komisionit të Venecias, të cilat deputetët po thonë që duhej t'i merrnim parasysh rekomandimet, të cilat i kemi pasur parasysh në projektligjin e parë pastaj të njëjtit me dritë të gjelbër të Komisionit të Venecias e kanë dërguar në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykata Kushtetuese ka dal kundër vlerësimit të komisionit të Venecias, për të gjitha rekomandimet. U përmend letra nga Zyra e BE-së, mirëpo, asnjëri nga deputetët nuk pati asnjë vërejtje përmbajtjesore dhe është mirë që BE-ja shkruan letra sepse i kemi miq dhe bashkëpunojmë me ta, por është duke u nënvlerësuar një grup pune ku kanë qenë plot anëtarë aty. Çështja për ta kapur sistemin e drejtësisë, kjo më habit sepse dikujt i duhet të kap sistemin atëherë kur i duhet për të kontrolluar sistemin e drejtësisë, që mos ta kap drejtësia, përndryshe nuk i nevojitet. Po ashtu, tha se duam të kemi një sistem të drejtësisë që del në sondazhe më mirë se Qeveria e Kuvendi e të gjithë organet e tjera Kushtetuese.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, me 6 vota për dhe 3 kundër, vendosi që Kuvendit t'i rekomandohet për miratim këtë:

R A P O R T

Për Projektligjin nr. 08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;

4. Shqyrtimi i Raportit për Projektligjin nr. 08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat Pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;

Kryetari, tha se pas miratimit në parim me datë 16.05.2024 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, bëhet fjalë për një nen të vetëm që i krijon mundësinë bashkëkombëseve tonë nga Lugina e Preshevës për të fituar të drejtën e pronësisë në pronë në Kosovë. Bëhet fjalë vetëm për një nen në këtë ligj dhe e kemi miratuar në Kuvend me konsensus edhe në komision dhe besoj që nuk kemi vërejtje për të ecur përpara.

Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se Komisioni, me 9 vota për, vendosi që Kuvendit dhe komisioneve të përherëshme t'ua paraqesë këtë :

R A P O R T

Projektligji nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës të miratohet pa amendamente.

5. Të ndryshme

Nuk pati çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Adnan Rrustemi,
Kryetar i Komisionit
